

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A.

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a.

Adresa Rruga Kavajes Nr.133, Njesia administrative Nr.6,Kodi Postar 1027

Tel/Faks 08004488

E-mail info@ukt.al

Ueb-faqe www.ukt.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Ilir Gavoçi

E-mail ilir.gavoçi@ukt.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: Punë (Modifikim kontrate)

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-81097-12-04-2020

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Modifikimi i Kontrates për objektin: “Shtesa e Impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë 1800l/s faza e 2 me 1200l/s”.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punë Ndërtimore kodi 45000000-7

8. Fondi limit: 1.762.045.692,08 (një miliard e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e dyzetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy presje zero tetë) lekë pa tvsh.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Neni 127 (Modifikimi i kontratës), Pika b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, që nuk mbulohen nga kontrata fillestare, të cilat janë bërë të domosdoshme prej rrethanave të paparashikuara dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:

I. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruarat gjatë procedurës fillestare;

II. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.

Autoriteti kontraktor ka nevojë për punë/shërbime shtesë të shkaktuar nga rrethana të paparashikuara që nuk varen nga autoriteti Kontraktor

Autoriteti kontraktor ka nevojë për shërbime shtesë, si rrjedhojë e punimeve të paparashikuara.

• Keto punë /shërbime shtesë nuk mund të ndahen teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjelle ndikime negative ose kosto të metejshme për autoritetin kontraktor;
Keto punime nuk mund të ndahen teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare me projektin e fillestar pasi duhet të përfundojë projekti dhe për të bërë të mundur: rritjen e cilësisë së ndërtimit dhe më kryesorja vendosjen në shfrytëzimin e objektit, ndryshime të cilat përmirësojnë treguesit e vepres.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Kryerja e punimeve shtesë në pjesën në të cilën nuk janë parashikuar volume punimesh në preventivin fitues për zërat e mëposhtëm:

- Transport dheu me auto deri 5 km
- Struktura betoni C 25-30 (Plinta e bazamente)
- F V hekur betoni i zakonshëm $\varnothing > 12$ mm
- Shpim me sonda me nevojën për kemishim gjatë procesit të shpimit $\varnothing 1000$ mm, thellësia (20-30 m)
- Shpim me sonda me nevojën për kemishim gjatë procesit të shpimit $\varnothing 1200$ mm, thellësia (20-30 m)
- Germim dheu bazament me makineri

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë të këtij objekti, kompleksitetin e të gjithë sistemit si dhe gjëndjen ekzistuese të terrenit ku shtrihet shtesa e impiantit u propozua të bëhet një studim i ri mbi kushtet Gjeologjiko-Inxhinierike të sheshit të ndërtimit, pasi në fazën e projektimit për shkak të terrenit si dhe objekteve ekzistuese ishte e pa mundur kryerja e shpimeve në të gjithë sheshin e ndërtimit dhe evidentimin e problematikave.

Pas lirimimit të sheshit të ndërtimit dhe prishjes së objekteve të cilat shtrihen në gjurmën e ndërtimit të objektit dhe pastrimit të gjithë territorit u bë një inspektim me I imtesishem I zones. Gjatë inspektimit u vu re një rrudhosje nga ana veriore e impiantit dhe thyrje e shtresave të sipërme që shprehte qartë mundësinë e një plani rreshqitjeje aktive.

Sipas kërkesave të përfaqësuesve të investitorit u kerkua të bëhet një studim i ri mbi kushtet Gjeologjiko-Inxhinierike të sheshit të ndërtimit, pasi në fazën e projektimit për shkak të terrenit si dhe objekteve ekzistuese ishte e pa mundur kryerja e shpimeve në të gjithë sheshin e ndërtimit dhe evidentimin e problematikave.

Në këtë fazë janë bërë testet si më poshtë:

- Jane kryer 18 shpime në thellësi 20 m (sipas rekomandimeve të ASTM)
- është kryer një rievim i detajuar gjeologjiko-inxhinierik për të vlerësuar qëndrueshmërinë e shpatit.
- Jane kryer 28 prova të tipit S.P.T sipas metodës (ISSMFE)
- Jane kryer 14 analiza granulometrike me sitat të tipit ASTM –series.
- Ajane kryer 14 analiza Atterberg Limits sipas metodës ASTM.
- Jane kryer 6 teste Odeometric test sipas ASTM.
- Jane kryer 8 teste Shear test sipas metodës SSHEN ISO 17892-10:2018.
- Jane shfrytëzuar 16 Unconfined Test për shkëmbinjtë sipas rekomandimeve të ISRM.

- Eshte bere interpretimi i te dhenave "INSITU" te laboratorit dhe raporti perfundimtar.
- Thellesia e shpimeve 20 m, eshte projektuar per te studiuar argjiliteti deri ne thellesine e pritshme per te takuar ndonje zone rreshqitese te vjeter. Ne kete zone kemi zhvendosje te depozitimeve deluvialo-eluviale mbi depozitimet Neogjenike dhe pjesa e formacionit rrenjesor.

Referuar raportit mbi kushtet gjeologjo-inxhinierike të sheshit të ndërtimitin , rekomandimeve të tij, masave inxhinierike që duhen marrë për stabilizimin e shpatit dhe efektin në godinat ekzistuese u moren masa për rillogaritjen e objekteve si dhe uljen sa me shume të rrezikut sipas rekomandimeve në raportin gjeologjik.

Gjithashtu një pikë e rëndesishme është edhe ulja e diferencuar që pësojnë sipërfaqet ku mbështeten objektet, pasi Objekti Depo e Akumulimit të ujit, Filtrat si dhe Flokulatoret etj mbështeten pjesërisht në sistemin me dhe të përforcuar me gjeogrid, pjesërisht në mbushje dhe pjesërisht në tokë natyrale të cilat janë parashikuar në projektin fillestar të tenderuar.

Referuar raportit gjeologjik si dhe raportit sizmik objektet u rillogariten si objekte të mbështetura mbi pilota. Kjo zgjidhje ul peshën e mbështetur në shpatin ku realizohet mbushja si dhe eliminon efektin e uljeve të diferencuara. Uljet e diferencuara do kishin efekt shume negativ në këto objekte pasi pervec problemeve strukturale që do shfaqeshin do kishim probleme dhe në funksionalitetin e gjithë sistemit pasi i gjithë sistemi funksionon duke respektuar rigorozisht kuotat e rrjedhjeve dhe nivelet e paracaktuara dhe tolerancat janë milimetrike.

Për të gjitha këto ndryshime, janë bërë matjet përkatëse të cilat janë pasqyruar në planimetritë e reja të objektit, dhe fletët e tjera të projektit, si edhe është hartuar preventivi i punimeve shtesë.

Per sa me siper:

Ndryshimet e propozuara jane te domosdoshme per te mundesuar rrijen e cilesise se ndertimit dhe kryesorja vendosjen ne shfrytezim te objektit, ndryshime te cilat permiresojne treguesit e vepres. Ndryshimet jane paraqitur ne Projektin e punimeve shtese, raportin gjeologo-inxhinierik, studimin inxhiniero-sizmologjik, duke marre parasysh te gjitha specifikimet e mundshme per realizimin dhe vendosjen ne funksion te objektit.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër

Vlera e kontratës pa t.v.sh është 1.679.455.513,85 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje tetëdhjetë e pesë) lekë

Vlera e kontratës me t.v.sh 1.933.781.616, 62 (një miliard e nëntëqind e tridhjetë e tre milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e dy) lekë.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 315,282,425 (treqind e pesëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e njëzetë e pesë) lekë pa tvsh.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 24 muaj duke nisur nga data e dorëzimi të sheshit të punimeve.

Dhe afati i ri (nëse është rasti): 16 muaj sipas grafikut të punimeve, nga përfundimi i afatit të parashikuar në kontratën bazë.

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

Emri: "FUSHA" sh.p.k

Adresa: Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga Murat Toptani, përballë Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja, Tiranë.

Nr.Nipti : J61922018S

Kontakti : 0698585999

Emri: “2T” sh.p.k

Adresa: Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5, Tiranë.

Nr.Nipti : K01731001M

Kontakti : : 042235802

Emri: “SHANSI INVEST” sh.p.k

Adresa: Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7, Tiranë.

Nr.Nipti : J61924002T

Kontakti : 042226256

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : 24.11.2023

16. Burimi i financimit: Të ardhurat e UKT sh.a

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____
